

There are no translations available.

Procedurat e zgjedhjes së tij

Të drejtën e kandidimit për President të BSPSH-së e kanë të gjithë drejtuesit e federatave sindikale që aderojnë në BSPSH në bazë të kërkesës së tyre për shpallje kandidature.

Këshilli Kombëtar miraton listën e kandidaturave alternative për President të BSPSH, mbi bazën e kërkesave me shkrim dhe në përputhje me kriteret e vendosura.

Presidenti zgjidhet në Kongres me votim të fshehtë me shumicë të thjeshtë votash 50%+ 1. Në rast se kandidatët në votimin e parë nuk sigurojnë shumicën e thjeshtë të votave, atëherë votimi përsëritet dhe fiton ai që merr më shumë vota. Kur Kongresit i paraqitet vetëm një kandidaturë për President lejohet t'i propozohet Kongresit mënyra e votimit të fshehtë apo të hapur.